[Shqiptarja.com]

E diel 30 Korrik 2023 - Përditësimi i fundit 09:19

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION
TË FUNDIT SOCIALE DREJT FUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI SOSLIE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5 Lajmet me të kërkuara në 5 minutat e fundit

1 Aktori i njohur Gino Fogg ujvari gjithë të ftu, kartëja kërkon ndihmë financiare për të jetësuar ndërhyjen kirurgjikale

2 Ni dashuri mund të bëhet diskutim, por...i fort thonë çat për ju sot

3 Po bëtarë për ty! Aktori Gent Fuga na njofton se ishte zëvendësuesi! Operacioni 19 mijë euro, apeli i bashkëshortes dha kotajtes gjen ndihmë

4 Lufta/ Gjoliteu dy ushtrisë së Maskës, sa i afërgjatë e Ukrainës ka, 55-vjeçari ende na arrati

5 Vrau gruan dhe e hodhi në gropën e ujërave, 55-vjeçari ende na arrati

Kronika

Maliq/ Burri vrau gruan dhe trupin ia hodhi në gropën e ujërave të zeza! Babai i 46-vjeçares: Kishte urdhër mbrojtje, ka tentuar më parë ta vrasë

Një ngjarje e rëndë u regjistrua mbrëmjen e kaluar në Maliq, ku një 46-vjeçare nëné e tre fëmijëve u vra nga bashkëshorti i saj. Pasi e vrau Luiza Mullalli, 55-vjeçari e hodhi atë në gropën e ujërave të zeza.

- Vrau gruan dhe e hodhi në gropën e ujërave të zeza, 55-vjeçari ende në arrati
- E rëndë në Maliq/ Burri vret gruan, trupin ia hedh në gropën e ujërave të zeza

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GjeniBotha

Redaksia
30 Korrik, 07:23 | Përditësimi: 30 Korrik, 09:06

MALIQ- Një ngjarje e rëndë ndodhi një natë më parë në Maliq, ku një ***46-vjeçare u vra*** nga bashkëshorti i saj, i cili më pas trupin e hodhi në gropën e ujërave të zeza. Luiza Mullalli, nëné e 3 fëmijëve, kishte marrë urdhër mbrojtje, pasi bashkëshorti i saj Gjergji Mullalli e dhunonte prej kohësh. Ka qenë i ati i 46-vjeçares që ka konfirmuar këtë detaj për mediat, duke thënë se urdhrin e mbrojtjes e kishte prej një viti.

> *"Erdhëm në shtëpi, mori djali se e kishte marrë në telefon për të biseduar. Më mori djali në telefon më thotë hajde se s'ma ngre telefonin se kushedi ca ka ndodhur. Erdha në shtëpi, erdhi djali në shtëpi, lajmëruam policinë, kërkuam vërdallë derisa e gjetën ata të policisë. E kishte hedhur nga veranda. Na ndaluan policët. Se pamë më deri. Kishin konflikte, kishte 1 vit me urdhër mbrojtje. E dhunonte vajzën dhe mori urdhër mbrojtje", thotë i ati Avzi Ferati.*

LEXO EDHE:
E rëndë në Maliq/ Burri vret gruan, trupin ia hedh në gropën e ujërave të zeza! Autori në arrati! Nëna e 46-vjeçares: E ka mbytur me çarçaf

I ati Avzi Ferato thotë se Gjergji Mullalli kishte tentuar t'ia vriste vajzën edhe më parë. Madje, ai shprehet se 55-vjeçari e kishte ndjekur kohët e fundit Liza Mullallin rreth dy ose tre herë në punë.

> *"Një ditë gjeti shtëpinë hapur, më merr në telefon më thotë kishte hy njeri brenda por se di kush. Para 3 ditësh, lajmëroi policinë. S'e kishte gjetur brenda dhomë. Në punë e kishte ndjekur nja 2-3 herë. E ndoqi për t'i thënë pse më ndjek mbrapa, ai kishte ikur. Vajza e kërkoi divorcin, se e dhunonte gjithnjë ai. Kishte vajtuar tek çupa tjetër në Greq, ai e goditi deshte ta mbyste. Kishte shpëtuar vajza nga duart. Nuk është dënuar ndonjëherë", thotë ai.*

Për shkak të dhunës së vazhdueshme që bashkëshorti ushtronte ndaj saj, Luiza Mullalli kishte kërkuar divorcin. Ka qenë djali i saj që ka njoftuar policinë për ngjarjen, ndërsa 55-vjeçari pas krimit është larguar dhe është ende në kërkim.

Lajm ne perditesim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 08:55

Burri e vrau dhe e hodhi në gropën e ujërave të zeza, del FOTO, ja kush është 46-vjeçarja



Kjo është 46-vjeçarja Luiza Mullalli e cila u vra nga bashkëshorti një natë më parë në Maliq, Gjergji Mullalli, pasi e vrau 46-vjeçaren me armë zjarri e hodhi atë në gropën e ujërave të zeza. 46-vjeçarja ishte nënë e tre fëmijëve.

SI.E./Shqiptarja.com

Ora 08:41

Vrau gruan dhe e hodhi në gropën e ujërave të zeza, 55-vjeçari ende në arrati

Gjergji Mullalli, autori i vrasjes së 46-vjeçares, Luiza Mullalli në Maliq është ende në kërkim. Bashkëshorti i 46-vjeçares është larguar nga vendi i ngjarjes. Policia në një njoftim zyrtar thotë se po vijojnë hetimet për ngjarjen,s i dhe puna për kapjen e autorit. 55-vjeçari akuzohet për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare".

> *"Në vijim të informacionit paraprak të dhënë mbrëmjen e djeshme i cili bën fjalë për një vrasje të ndodhur në fshatin Zërnblak, Maliq, ju informojmë se:*
>
> *Specialistet e Seksionit për Hetimin e Krimeve kundër Jetës dhe Personit të DVP Korçë, në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Maliq, në vijim të veprimeve procedurale të kryera në lidhje me këtë ngjarje referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasin Gj. M., 55 vjeç, banues në fshatin Zërnblak, për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare". Nga hetimet e kryera dyshohet se ky shtetas për motive të dobëta ka vrarë me armë zjarri bashkëshorten e tij shtetasen L. M., 46 vjeçe, të cilën më pas e ka hedhur në një gropë septike, pranë banesës së saj.*
>
> *Nga ana e Policisë po vijon puna intensive për kapjen e autorit të dyshuar dhe dokumentimin e plotë të ngjarjes.*
>
> *Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprime të mëtejshme", njofton policia.*

SI.E./Shqiptarja.com

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Gjergji mullalli Krime luiza mullalli

Komento

Ndalohet riprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Mendoni se rikthimi i Bashës në krye e ringre PD-në?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

SPECIALE/ Në Lin, vendbanimi më i vjetër në Evropë

Armand Braho

29 Korrik, 20:28

Korçë, vijojnë radhët e gjata në pikën e kalimit kufitar të Qafë Thanës

29 Korrik, 16:27

Shpërthen bombola e gazit në një banesë në Pogradec, një lënduar

29 Korrik, 14:49

PD zgjedh sot kryetarin e ri, krerët e degëve në Vlorë e Korçë: S'ka problematika pjesëmarrje e ulët, procesin se ka ndalur dot Berisha e jo më Bardhi

29 Korrik, 11:40

VIDEO+ FOTO/ Të gjithë fitues, mbahet për herë të parë maratona e bebavë në Pogradec! 50 vogëlushë nga 6-15 muajsh morën pjesë në garë

Armand Braho

29 Korrik, 11:19

Sot maratona në Pogradec, policia ndan planin e masave! Ja akset rrugore që do të bllokohen

29 Korrik, 09:13

Aksident në Pogradec, kamioni del nga ruga! Plagoset shoferi 43-vjeçar dhe pasagjeri

29 Korrik, 09:05

Nesër maratona në Pogradec, policia ndan planin e masave! Ja akset rrugore që do të bllokohen

28 Korrik, 17:29

Maliq/ Investoi në Shqipëri, arabit i digjen 7 ha grurë: Nuk e di shkakun, pres mbështetje nga shteti shqiptar

Armand Braho

28 Korrik, 16:13

EMRAT/ Arrestohen tregtarët e natës në Korçë! Në banesë iu gjetën 500 gr kokainë e ndarë në doza gati për shitje

28 Korrik, 10:31

Pogradec, vëllai godet me thikë vëllanë pas sherrit për pronën! I ikën policisë

27 Korrik, 22:26

VIDEO/ Rradhë të gjata mjetesh në Pikën e Kalimit Kufitar të Qafë-Thanës

Armand Braho

27 Korrik, 19:58

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje